



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 3423/prot.

Tiranë, më 30.01.2023

/4

VENDIM

Nr. 05, datë 30.01.2023

**“Për shtyrjen e procesit të pranimit të kandidatëve për 1 (një) vend vakant për anëtar i Bordit të Administrimit të UT-së, të propozuar nga studentët e UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për këtë vend vakant”**

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, pika 7 dhe neni 38; në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, Vendimit nr. 17, datë 16.01.2023 të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës

**VENDOSI:**

1. “Të miratojë shtyrjen e procesit për pranimin e kandidaturave për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar i Bordit të Administrimit të UT-së”, të propozuar nga studentët e UT-së, për arsye të mospërbushjes së mundësisë së përzgjedhjes nga tri kandidatura, sipas pikës 6 të Vendimit nr. 782, date 26. 12. 2018, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë.
2. Ky vendim i përcillet për njohje të gjitha njësive përbërëse të Universitetit të Tiranës.
3. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e UT-së dhe në faqen e tij zyrtare.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Prof. Dr. Artan Hoxha

